



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 03.12.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:54 dhe mbaroi në orën 10:59.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ilir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Fatmira Luli.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Buxhetit Gjyqësor.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në sistemin gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Deklaroj të hapur mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, në këtë mbledhje janë prezent të gjithë anëtarët, përveç zonjës Luli e cila për arsye shëndetësore nuk është e pranishme, e ka të pamundur të jetë në këtë mbledhje.

Lidhur me rendin e ditës në këtë mbledhje, siç jeni vënë në dijeni, do të marrim në shqyrtim projektvendimin “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, në sistemin gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe për ta relatuar këtë projekt-akt, kam ftuar zonjën Luljeta Laze, e cila do të bëjë një relatum më të detajuar dhe sqarues mbi nevojën e ndërmarrjes së këtij projektvendimi, miratimit të këtij projektvendimi.

Për ju fjala zonja Laze!

Luljeta Laze: Faleminderit!

Praktikisht ndodh ajo që neve e diskutuam para disa kohësh çështjen e rialokimit të fondeve dhe besoj që edhe me hartimin e rregullores do gjejë vend ashtu siç duhet. Ky është një rast konkret ku jemi – si të thuash – në fund të periudhës, ne kemi nevojë për disa rialokime fondesh që kanë të bëjnë me fondin e pagave. Kemi një nevojë për një

shtesë fondi në fondet e pagave të KLGJ-së, por gjithashtu na janë paraqitur edhe 4 raste nevojash nga gjykatat. Sigurisht, me thënë të drejtën është pak vonë sot, por ka qenë edhe kjo situata... ndoshta duhet të ishte verifikuar edhe para disa ditësh, por ka qenë kjo situata e këtyre 4-5 ditëve që nuk kanë qenë dhe kanë raportuar me vonesë.

Pasi kemi verifikuar situatën dhe mundësinë se nga mund t'i marrim fondet që janë të nevojshme për fondin e pagave, mund t'ju relatoj si më poshtë:

Fondet që janë të nevojshme për KLGJ-në, brenda fondeve të saj, nga shpenzimet operative do të kalojë në fondin e pagave 3 500 mijë lekë dhe gjithashtu keni edhe një tabelë e cila tregon ndryshimin e fondeve, cilat janë fondet që pakësohen (në tabelën 1) dhe cilat janë fondet, zëri përkatës, i cili shtohet.

Gjithashtu kemi nevojë edhe për disa gjykata. Ka nevojë Gjykata e Tiranës për një fond 21 000 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Vlorë 3 600 mijë lekë; Gjykata e Rrethit Lezhë 300 mijë lekë dhe; Gjykata e Rrethit Durrës 800 mijë lekë. Për gjykatat kemi operuar me fondet e lira të vetë fondit të pagave, brenda fondit të pagave, dhe kryesisht ato janë marrë nga Gjykata e Lartë e cila ka pasur fonde të lira.

Kjo është që është e pasqyruar edhe në tabelën përkatëse: Tregon fondet që do shtohen për secilën dhe fondi ku do pakësohet.

Për këtë kërkojmë miratimin e Këshillit. Kaq është.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Laze!

Nëse kemi ndonjë diskutim apo informacion që e kërkojmë për sqarim para se ta kalojmë në vendimmarrje?

Atëherë, të procedojmë? Jemi dakord me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni përkatës dhe sqaruar nga zonja Laze?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor, si më poshtë: a) Rialokimim e fondeve në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim” 1110, pakësuar nga shpenzimet operative, shtuar në shpenzime paga, për vlerën 3 500 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi. b) Rialokimin e fondeve në programin “Buxheti gjyqësor” 3310, pakësuar nga shpenzime paga (fonde të lira), shtuar në shpenzime për paga, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur këtij vendimi në favor të: Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerën 21 000 lekë; Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për vlerën 3 600 lekë; Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për një vlerë 300 mijë lekë; Gjykatës së Apelit Durrës, për një vlerë 800 mijë lekë. 2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse nuk kemi ndonjë gjë për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit për prezencën!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor